



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

**NJOFTIM PËR PJESËMARRJE NË KONKURSIN E REALIZIMIT TË
“LOGOS” PËR KONFERENCËN MINISTRORE DHE DIALOGUT TË
POLITIKAVE GLOBALE, MAJ 2024**

Me rastin e Konferencës Ministrore dhe Dialogut të Politikave Globale, që do të mbahet në Tiranë, në datat 29-30 Maj, 2024, Ministria e Arsimit dhe Sportit, fton çdo krijues të bëhet pjesë, duke konkurruar për realizimin e “Logos” e cila do të jetë simbolikë përfaqësuese e Konferencës.

Realizimi i kësaj “Logo” duhet të pasqyrojë konfiguracionin simbolik, si pjesë identifikuese e Konferencës Ministrore dhe Dialogut të Politikave Globale, lidhur me Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor.

Tema do të jetë “Zona Evropiane e Arsimit të Lartë drejt 2030/Zona Evropiane e Arsimit të Lartë - Tirana 2024”.

Afati i dorëzimit të aplikimit është data **15 Shkurt 2024**.

Në konkurs kanë të drejtë të marrin pjesë student, artistë, krijues në fushën e arteve pamore.

Dosja e plotësuar duhet të dorëzohet me email në adresën: info@arsimi.gov.al dhe përmes postës në adresën e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit brenda datës së përcaktuar në afatin përmbyllës të konkursit.

Dosja e pjesëmarrësit duhet të ketë:

- Kartë identiteti (jpg/pdf)
- CV (word/pdf)
- Punimi i logos (duhet të paraqitet në sfond të bardhë, të zi dhe me ngjyrë, si dhe të dorëzohet në formatet: Eps; Pdf; Jpg; Png)

Punimet e Logos, duhet të jenë origjinale, të pa publikuara dhe autori mban përgjegjësi ligjore për autenticitetin e tyre para ligjit. Në konkurs pranohen punime individuale dhe punime të realizuara në grup.

Fituesi i konkursit përcaktohet nga një grup i përbërë me ekspertë të fushës, i ngritur për këtë qëllim në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, brenda 5 ditëve pune nga përfundimi i afatit të dorëzimit.

Duke ju falënderuar,